

*Zyra e Rregullatorit për Energji
Rr. Hamdi Mramori Nr. 1
Prishtinë10000– Kosovë
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org*

Zyra e Rregullatorit për Energji

**Rregulla për vënien e çmimeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike
(Rregulla për Çmimet e FPÉE-së)**

D R A F T

2011

Përmbajtja

Kapitulli 1	Kushtet e Përgjithshme	3
Neni 1	Hyrje	3
Neni 2	Qëllimi dhe fushëveprimi	3
Neni 3	Definicionet dhe përkufizimet	3
KAPITULLI 2	Tarifa e Rregulluar me Pakicë	6
Neni 4	Parimet e Përgjithshme	6
Neni 5	Shqyrtimet Periodike dhe Periudhat Rregullative	6
Neni 6	Përshtatjet e Rregullta dhe Periudhat e Përshtatjes	7
Neni 7	Shqyrtimet e Jashtëzakonshme	8
Kapitulli 3	Të Hyrat Maksimale të Lejuara	9
Neni 8	Parimet e Përgjithshme	9
Neni 9	Shpenzimet e Lejuara Operative	9
Neni 10	Kostot e Lejuara të Blerjes së Energjisë me Shumicë	10
Neni 11	Kostoja me shumicë për Kapacitet	12
Neni 12	Bartja e Ngarkesave të OT-së	12
Neni 13	Bartja e Ngarkesave të OS-së	13
Neni 14	Bartja e Ngarkesave TUOS	13
Neni 15	Bartja e Ngarkesave DUOS	13
Neni 16	Bartja e Taksave të Licencës	13
Kapitulli 4	Metodologjia për Strukturën Tarifore	14
Neni 17	Metodologjia për Strukturimin e Tarifës së Rregulluar me Pakicë	14
Shtojca 1	Llogaritja e Të Hyrave Maksimale të Lejuara	15
Shtojca 2	Baza e Aseteve të Rregulluara	18
Shtojca 3	Procesi i Shqyrtimit Periodik	20
Shtojca 4	Procesi i Përshtatjeve të Rregullta	22
Shtojca 4	Procesi i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm	23
Shtojca 5	Ngjarjet e Jashtëzakonshme	25
Shtojca 6	Ngjarja e Forcës Madhore	26
Shtojca 7	Periudha Tranzitore	27

KAPITULLI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Hyrje

- 1 Kjo Rregull është miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (“Rregullatorit”) në seancën publike të mbajtur më [data], në bazë të autoritetit të dhënë në Nenin 8 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 2 Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1 Kjo Rregull cakton:
 - 1.1 Metodologjinë për përcaktimin e Tarifës së Rregulluar me Pakicë që mund të ngarkohet nga Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike (“FPEE”) për furnizimin me pakicë të energjisë elektrike; dhe
 - 1.2 Procedurën për Shqyrtimin dhe Përshtatjen e Tarifës së Rregulluar me Pakicë.
- 2 Kjo Rregull vlen për të gjithë konsumatorët të cilët ngarkohen me tarifë të rregulluar të energjisë elektrike (“Konsumatorë të Rregulluar”). Për shmangje të dyshimit, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Konsumatorët e Rregulluar përfshijnë:
 - 2.1 Të gjithë konsumatorët e pakualifikuar; dhe
 - 2.2 Konsumatorët e kualifikuar kur Rregullatori nuk është i kënaqur me nivelin e zhvillimit të konkurrencës efektive në furnizim.

Neni 3 Definicionet dhe përkufizimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë këtë kuptim:
 - 1.1 “Të Hyra të Rregulluara Aktuale” nënkupton të Hyrat e mbuluara nga FPEE duke ngarkuar Tarifën e Rregulluar me Pakicë ndaj Konsumatorëve të Rregulluar, matur në baza aktuale;
 - 1.2 “Plan i Aprovuar Investiv” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 2;
 - 1.3 “Borxhi i Keq i lejuar” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 9 paragrafin 6;
 - 1.4 “Ditë Pune” quhen të gjitha ditët e punës brenda një jave, të përcaktuara sipas Ligjeve në Kosovë;
 - 1.5 “Grup i Konsumatorëve” nënkupton klasifikimin e llojeve të ndryshme të konsumatorëve për qëllime të ngarkimit me tarifën me pakicë. Klasifikimi duhet të ketë parasysh metodën e konsumatorëve të konsumit të energjisë dhe kapacitetit, metodën e konsumit të energjisë elektrike, ngarkesën e pikut, tensionin e furnizimit dhe karakteristikat që kanë ndikim në koston e furnizimit;
 - 1.6 “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” apo “OSSH” nënkupton bartësin e Licencës për Operator të Sistemit të Shpërndarjes;

- 1.7 “Ngarkesa për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes” apo “Ngarkesa DUOS” nënkupton ngarkesën e rregulluar të ngarkuar ngë OSSH për shpërndarjen e energjisë elektrike në sistemin e tyre;
- 1.8 “Jetëgjatësia Ekonomike” nënkupton jetëgjatësinë e përdorur për llogaritjen e zhvlerësimit të lejuar nga Baza e Aseteve të Rregulluara;
- 1.9 “Nxitja për Eksport” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 10 paragrafin 11;
- 1.10 “EURIBOR” nënkupton Normën e Ofrimit për Depozita të Euros nga Federata Bankare Evropiane për periudhë 3 mujore, që paraqitet në faqen e caktuar të shërbimit të Reuters në ora 11:00 (kohë e matur sipas Kohës Qendrore Evropiane) ose, në rast se Reuters nuk vazhdon ta ofrojë këtë shërbim, cilado agjenci tjetër e pajtuar në mes të OSSH-së dhe Rregullatorit. Për shmangje të dyshimit kjo do të jetë normë vjetore;
- 1.11 “Gjoha për Eksport” ka kuptimin që i është dhënë në 7 paragrafin 6;
- 1.12 “Përshtatje e Jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5;
- 1.13 “Ngjarje e Jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
- 1.14 “Shqyrtim i Jashtëzakonshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7;
- 1.15 “Vendim Final” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3 paragrafin 9;
- 1.16 “Ngjarje e Forcës Madhore” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 7;
- 1.17 “Taksa për Licencë” nënkupton shumën për pagesë sipas Nenit 7 të Pasqyrës së Taksave, që lëshohet nga Rregullatori dhe mund të amandamentohet;
- 1.18 “Operator i Tregut” apo “OT” nënkupton bartësin e Licencës për Operim të Tregut;
- 1.19 “Rregullat e Tregut” ka kuptimin [do të definohen me rastin e përcaktimit të Rregullave të Tregut];
- 1.20 “Pragu i Materialitetit” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5;
- 1.21 “Të Hyra Maksimale të Lejuara” ose “MAR” nënkuptojnë të Hyrat maksimale që mund të mbulohen brenda një Viti Relevant nga FPEE përmes Tarifës së Rregulluar me Pakicë, të cilat rregullohen sipas formulave të Shtojcës 1 të kësaj Rregulle;
- 1.22 “Vlera Neto e Tanishme” nënkupton metodën e zhvlerësimit të rrjedhave të ardhshme të parasë;
- 1.23 “Shqyrtimi Periodik” nënkupton shqyrtimin nga Rregullatori për të përcaktuar të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Tarifën e Rregulluar me Pakicë për FPEE për Periudhën e ardhshme Rregullative;
- 1.24 “Propozim” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3 Paragrafin 4;
- 1.25 “Vendim i Përkohshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3 paragrafin 6;
- 1.26 “Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike” apo “FPEE” nënkupton bartësin e licencës për Furnizim Publik;

- 1.27 “Përshtatje e Rregullt” nënkupton përshtatjen Mekanike të Të Hyrave Maksimale të Lejuara që bëhet rreth fundit të çdo Viti Relevant;
 - 1.28 “Konsumator i Rregulluar” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 2 paragrafin 2;
 - 1.29 “Tarifë e Rregulluar me Pakicë” nënkupton bashkësinë e çmimeve të ngarkuara nga FPEE ndaj Konsumatorëve të Rregulluar për ofrimin e Shërbimeve Standarde, siç përcaktohen nga Rregullatori;
 - 1.30 “Rregullatori” nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji;
 - 1.31 “Bazë e Aseteve të Rregulluar” ka kuptimin që i është dhënë Shtojcën 2;
 - 1.32 “Periudhë Rregullative” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5 paragrafin 3;
 - 1.33 “Vit Relevant” nënkupton periudhën 12 mujore në mes të Përshtatjeve të Rregullta;
 - 1.34 “Marzha me Pakicë” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 9 paragrafin 7;
 - 1.35 “Shërbime Standarte” nënkupton shërbimet e ofruara ndaj konsumatorëve për furnizimin me energji elektrike nga FPEE siç janë definuar në Licencën për Furnizim Publik dhe Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
 - 1.36 “Deklaratë e Ndikimit Financiar” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5;
 - 1.37 “Operator Sistemi” apo “OS” nënkupton bartësin e Licencës për Operim të Sistemit;
 - 1.38 “Periudhë Tranzitore” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
 - 1.39 “Operator i Sistemit të Transmisionit” apo “OST” nënkupton bartësin e Licencës për Operimin e Sistemit të Transmisionit;
 - 1.40 “Ngarkesë për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit” apo “Ngarkesë TUOS” nënkupton ngarkesën e rregulluar të aplikuar nga OST për bartjen e energjisë elektrike në rrjetin e tyre;
 - 1.41 “Konsumatorë të Parregulluar” nënkupton çdo konsumator i FPEE-së që nuk është konsumator i Rregulluar;
 - 1.42 “Marzha e Energjisë me Shumicë” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 10 paragrafin 10;
 - 1.43 “X-faktori” nënkupton faktorin e përcaktuar në Shqyrtimet Periodike dhe të aplikuar në të hyrat e lejuara me pakicë.
- 2 Termat e tjera të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Energjinë.

KAPITULLI 2 TARIFA E RREGULLUAR ME PAKICË

Neni 4 Parimet e Përgjithshme

- 1 FPEE do t'i ngarkojë Konsumatorët e Rregulluar me Tarifën e Rregulluar me Pakicë.
- 2 Tarifa e Rregulluar me Pakicë do të përcaktohet dhe aprovohet gjatë çdo Përshtatjeje të Rregullt, ashtu që:
 - 2.1 Brenda secilit Vit Relevant, të Hyrat që FPEE parashikon të mbledhë nga Tarifa e Rregulluar me Pakicë janë saktësisht të barabarta me Të Hyrat Maksimale të Lejuara (Kapitulli 3); dhe
 - 2.2 Tarifa e Rregulluar me Pakicë është në përputhje me Metodologjinë e Strukturës Tarifore (Kapitulli 4).
- 3 Të Hyrat Maksimale të Lejuara përbëhen nga shuma e
 - 3.1 Kostove të lejuara me pakicë;
 - 3.2 Kostot e lejuara të blerjes me shumicë, duke përfshirë këtu kostot e energjisë dhe kostot e kapacitetit; dhe
 - 3.3 Kostot që barten, duke përfshirë kostot e OT-së, OS-së, Ngarkesën TUOS, Ngarkesën DUOS dhe Taksën për Licencë.
- 4 Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përcaktohen si më poshtë:
 - 4.1 Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të caktohen në Shqyrtime Periodike (Neni 5);
 - 4.2 Para përfundimit të Vitit Relevant, do të aplikohet Përshtatja e Rregullt që përfshin përshtatjen mekanike të Të Hyrave Maksimale të Lejuara për të marrë parasysh ndryshimet në kostot që konsiderohen të jenë jashtë kontrollit të FPEE-së (duke përfshirë këtu kostot që barten); dhe
 - 4.3 Shqyrtimet e Jashtëzakonshme (Neni 7), që përfshijnë përshtatjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara për ndryshimet materiale në kosto apo në të Hyra e që shkaktohet nga një Ngjarje e Jashtëzakonshme, do të realizohen kur është e nevojshme.
- 5 Provizionet Tranzitore të dhëna në Shtojcën 8 do të aplikohen deri më 31 mars 2015.

Neni 5 Shqyrtimet Periodike dhe Periudhat Rregullative

- 1 Të Hyrat Maksimale të Lejuara të FPEE-së për Periudhën e ardhshme Rregullative do të caktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike;
- 2 Shqyrtimet Periodike do të mbahen para çdo Periudhe Rregullative.
- 3 Secila Periudhë Rregullative do të jetë 5 vjeçare, përveç:
 - 3.1 Gjatë Periudhës Tranzitore të dhënë në Shtojcën 8; dhe

- 3.2 Në rast të pajtimit në mes të FPEE-së dhe Rregullatorit, Periudha Rregulative mund të shkurtohet apo zgjatet.
- 4 Procedura për mbarëvajtjen e Shqyrtimeve Periodike është dhënë në Shtojcën 3.

Neni 6 Përshtatjet e Rregullta dhe Vitet Relevante

- 1 Gjatë Përshtatjeve të Rregullta do të llogaritet ndryshimi i lejuar në Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Tarifa rezultuese e Rregulluar me Pakicë.
- 2 Përshtatjet e Rregullta do të bëhen para çdo Viti Relevant.
- 3 Çdo Vit Relevant do të zgjatë 1 vit dhe Viti i parë Relevant do të fillojë 12 muaj pas fillimit të Periudhës së Kaluar për përshtatje apo ndonjë periudhë tjetër të vendosur nga Rregullatori.
- 4 Ndryshimi në Të Hyra Maksimale të Lejuara në secilën Përshtatje të Rregullt do të bazohet në:
- 4.1 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e Të Hyrave Maksimale të Lejuara në Vitin Relevant për shkak të ndryshimeve në mes të faturimeve të parashikuara dhe faturimeve të realizuara;
- 4.2 Përshtatjet e Të Hyrave Maksimale të Lejuara për të marrë parasysh ndryshimet në Koston e parashikuar të Energjisë me Shumicë dhe në parashikimin e kostove që barten; dhe
- 4.3 Nën-mbulimin dhe mbi-mbulimin e kostove të pakontrollueshme në Vitin e tanishëm Relevant, për të marrë parasysh ndryshimet në mes të kostove të parashikuara dhe kostove të realizuara.
- 5 Kostot e pakontrollueshme janë ato të cilat:
- 5.1 Janë në masë të madhe jashtë kontrollit të FPEE-së;
- 5.2 Potencialisht mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në gjendjen financiare të FPEE-së dhe aftësinë e FPEE-së për të ofruar Shërbimet Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar; dhe
- 5.3 Mund të verifikohen në mënyrë të pavarur.
- 6 Kostot e pakontrollueshme përfshijnë:
- 6.1 Kostot e blerjes së energjisë me shumicë duke përfshirë këtu koston e energjisë (Neni 10) dhe koston e kapacitetit (Neni 11); dhe
- 6.2 Kostot që barten, duke përfshirë këtu Ngarkesat për OT-në (Neni 12), Ngarkesat për OS-në (Neni 13), Ngarkesën TUOS (Neni 14), Ngarkesën Duos (Neni 15) dhe Taksën për Licenca (Neni 16).
- 7 Formulatat për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara gjatë Përshtatjeve të Rregullta janë dhënë në Shtojcën 1.
- 8 Procedura për realizimin e Përshtatjeve të Rregullta është dhënë në Shtojcën 4.

Neni 7 Shqyrtimet e Jashtëzakonshme

- 1 Shqyrtimet e Jashtëzakonshme mund të shkaktohen nga Ngjarjet e Jashtëzakonshme, të definuara sipas Shtojcës 6.
- 2 Gjatë Shqyrtimeve të Jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i Ngjarjes së Jashtëzakonshme në të Hyrat Maksimale të Lejuara për pjesën e mbetur të Periudhës Rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se Pragu i Materialitetit, atëherë do të bëhet Përshtatje e Jashtëzakonshme;
- 3 Llogaritja e ndikimit mbi të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe e Përshtatjes së Jashtëzakonshme nuk duhet të marrë parasysh faktorë të cilët nuk janë të ndërlidhur në mënyrë direkte me Ngjarjen e Jashtëzakonshme.
- 4 Për shmangje të dyshimit, Rregullatori do të marrë parasysh ndikimin e Ngjarjeve të Jashtëzakonshme (që e kalojnë Pragu e Materialitetit) në Shqyrtimet Periodike pasuese.
- 5 Procedura për mbarëvajtjen e Shqyrtimeve të Jashtëzakonshme është dhënë në Shtojcën 5.

Neni 8 Parimet e Përgjithshme

- 1 Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të jenë të barabarta me kostot e arsyeshme të FPEE-së për ofrimin e Shërbimeve Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar, dhe me kusht që këto kosto të jenë të arsyeshme dhe vlerësuara saktësisht.
- 2 Kostot e arsyeshme të FPEE-së do të përfshijnë:
 - 2.1 Kostot e lejuara me pakicë (Neni 9), të cilat do të përshtaten për të marrë parasysh inflacionin dhe të cilave do t'u zbritet X-faktori gjatë Përshtatjeve të Rregullta por të cilat do të jenë fikse në mes të Shqyrtimeve Periodike;
 - 2.2 Kostot e blerjes së energjisë me shumicë, duke përfshirë këtu kostot për energji (Neni 10) dhe kostot për kapacitet (Neni 11) të cilat do të barten në mënyrë të plotë gjatë Përshtatjeve të Rregullta, përveç Marzhës me Shumicë dhe Nxitjes për Eksport; dhe
 - 2.3 Kostot e bartura, të cilat përfshijnë Kostot e OT-së (Neni 12), Ngarkesën TUOS (Neni 14), Ngarkesën DUOS (Neni 15) dhe Taksat për Licenca (Neni 16) të cilat do të barten në mënyrë të plotë.
- 3 Gjatë përcaktimit të kostove të lejuara, Rregullatori do t'u referohet, në mes tjerash edhe:
 - 3.1 Performancës së kaluar;
 - 3.2 Performancës së parashikuar;
 - 3.3 Krahasimeve me ndërmarrje të ngjashme në Kosovë dhe gjetiu në Evropë; dhe
 - 3.4 Krahasimeve me kostot e aktiviteteve të ngjashme në Kosovë dhe gjetiu në Evropë.
- 4 Çdo e Hyrë tjetër, që nuk është mbledhur nga tarifat, por që ka të bëjë me ofrimin e Shërbimeve Standarde për Konsumatorët e Rregulluar do të zbritet nga Të Hyrat Maksimale të Lejuara.
- 5 Gjatë Rishikimeve Periodike, Rregullatori mund të përshtatë profilin e të Hyrave Maksimale të Lejuara që priten të mbulohen në çdo Vit Relevant në mënyrë që të minimizojë ndryshimet e menjëhershme të të Hyrave Maksimale të Lejuara.
- 6 Gjatë tërë kohës, Vlera Neto e Tanishme e të Hyrave Maksimale të Lejuara të parashikuara duhet të jetë e barabartë me Vlerën Neto të Tanishme të kostove të lejuara të parashikuara të FPEE-së.
- 7 Formulat për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara janë dhënë në Shtojcën 1.

Neni 9 Shpenzimet e Lejuara Operative

- 1 Kostot e lejuara me pakicë do të përshtaten për të marrë parasysh inflacionin dhe për të zbritur X-faktorin gjatë Përshtatjeve të Rregullta, sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1, dhe do të mbesin të fiksuara në mes të Shqyrtimeve Periodike.
- 2 Kostot e lejuara me pakicë do të përfshijnë kostot e lejuara që kanë të bëjnë me furnizimin e Konsumatorëve të Rregulluar:

- 2.1 Kostot e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes;
 - 2.2 Kostot e korporatës;
 - 2.3 Kostot e Zhvlerësimit;
 - 2.4 Kostot e lejuara të Borxhit të Keq;
 - 2.5 Marzhën me pakicë; dhe
 - 2.6 Çdo kosto tjetër me të cilën në mënyrë të arsyeshme është ballafaquar FPEE-ja gjatë ofrimit të shërbimeve me pakicë ndaj Konsumatorëve të Rregulluar.
- 3 Kosto e lejuar operative dhe e mirëmbajtjes nuk do të përfshijë:
 - 3.1 Kostot e reklamimit dhe formave tjera të marketingut për arsye se FPEE-ja nuk ka konkurrencë për Konsumator të Rregulluar; dhe
 - 3.2 Taksat apo detyrimet që do të mblidhen nga Marzha me Pakicë.
 - 4 Kostot e lejuara të korporatës përfshijnë kostot (ose një pjesë të kostos totale të korporatës nëse FPEE-ja është kompani bijë apo kompani degë e ndonjë entiteti tjetër) që janë të nevojshme dhe i atribuohen funksionimit të rregullt të FPEE-së por që nuk janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me ofrimin e Shërbimeve Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar.
 - 5 Kostot e lejuara të zhvlerësimit do të llogariten në bazë të metodës lineare si funksion i Jetëgjatësisë Ekonomike të Aseteve dhe Bazës së Aseteve të Rregulluara, siç përshkruhet në Shtojcën 2.
 - 6 Kostot e lejuara të Borxhit të Keq do të llogariten duke aplikuar Lejesën për Borxhin e Keq sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1. Lejesa për Borxhin e Keq do të jetë një vlerësim i përafërt i nivelit të arsyeshëm të Borxhit të Keq që mund ta ketë një ndërmarrje që merret me furnizim publik, duke marrë parasysh provizionet ligjore të Ligjit për Tatimin e Korporatave. Lejesa për Borxhin e Keq do të përcaktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike.
 - 7 Marzha me Pakicë do t'i ofrojë FPEE-së një nivel të arsyeshëm të Kthimit të Lejuar për ta kompensuar për riskun që ndërmerr në ofrimin e Shërbimeve Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar, kthimin mbi Bazën e Aseteve të Rregulluar të FPEE-së dhe koston e ofrimit të kapitalit punues. Marzha me pakicë do të përcaktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike. FPEE-ja nuk do të ketë kthim të lejuar mbi asetet e financuara nga grantet kapitale.
 - 8 Kostoja totale me pakicë për çdo konsumator do të llogaritet për të përcaktuar kostone lejuar me pakicë. Kjo llogaritje do të marrë parasysh ndryshimin në kosto që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve ndaj Grupeve të ndryshme të Konsumatorëve. Këto kosto për çdo konsumator do të shumëzohen me numrin e Konsumatorëve të Rregulluar, do të përshtaten për kostot e ndryshme të ofrimit të shërbimeve me pakicë, për të arritur në Kostot e Lejuara me pakicë që duhet të mbulohen nga Konsumatorët e Rregulluar.

Neni 10 Kostot e Lejuara të Blerjes së Energjisë me Shumicë

- 1 Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përshtaten gjatë Përshtatjeve të Rregullta për të reflektuar ndryshimet në koston e lejuar për blerje të energjisë me shumicë, sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1. Kjo përshtatje do të marrë parasysh nën-mbulimet apo mbi-mbulimet e kostove të blerjes së energjisë me shumicë gjatë Vitit të tanishëm Relevant, Marzhën e

Energjisë me Shumicë dhe Nxitjen për Eksport si dhe do të azhurnojë parashikimet për Vitin e ardhshëm relevant.

- 2 Kostot e lejuara të blerjes së energjisë me shumicë, nëse kanë të bëjnë me shërbimin ndaj Konsumatorëve të Rregulluar, përfshijnë:
 - 2.1 Kostot e blerjes së energjisë nga gjeneratorët vendor;
 - 2.2 Kostot e importit të energjisë;
 - 2.3 Kostot neto të balancimit;
 - 2.4 Të Hyrat që kanë të bëjnë me humbjet në rrjetin e transmisionit dhe të distribucionit (si kosto negative);
 - 2.5 Përshtatjen për Marzhën e Energjisë me Shumicë;
 - 2.6 Nxitjen për Eksport; dhe
 - 2.7 Ndëshkimin për Eksport.
- 3 Kostot e lejuara të blerjes së energjisë nga gjeneratorët vendor do të përfshijnë koston e realizuar të FPEE-së për blerjen e energjisë nga gjeneratorët në Kosovë (si të rregulluar, ashtu edhe të parregulluar) për blerjen e energjisë për të furnizuar Konsumatorët e Rregulluar, siç përcaktohet në Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë.
- 4 Kostoja e lejuar e blerjes së energjisë nga gjeneratorët vendorë nuk do të përfshijë koston shtesë të gjeneratorëve që mbulohej nga mekanizmat e jashtëm, siç është për shembull ndryshimi në mes të nivelit të tarifës Feed-in dhe koston mesatare të blerjes së energjisë me shumicë, që përdoret për blerje të energjisë nga gjeneratorët e burimeve të ripërtërishme.
- 5 Kostoja e lejuar e blerjes së energjisë nga importi do të jetë kostoja e realizuar nga FPEE-ja për blerjen e energjisë nga importi, e përcaktuar nga kontratat e importit, duke moë përfshirë këtu subvencionet për import të dhëna nga Qeveria e Kosovës, përveç gjatë Periudhës Tranzitore të dhënë në Shtojcën 8.
- 6 [Siç kërkohet në Licencën për Furnizim Publik, FPEE-ja do të përdorë të gjitha mjetet për të siguruar se importet prokurohen në mënyrë efikase dhe nuk duhet të eksportojë energji atëherë kur në Kosovë ka shkycje të energjisë elektrike për shkak të mungesës së kapaciteteve gjeneruese apo importit.]
- 7 Kostot neto të balancimit do të përfshijnë ndryshimin në mes të kostove të realizuara dhe të Hyrave të fituara (siç përcaktohen në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut) që rezultojnë nga delbalanci në mes të kërkesës aktuale nga Konsumatorët e Rregulluar dhe furnizimin e kontraktuar me energji. Rregullatori ka të drejtë të përfshijë edhe një mekanizëm shtesë për ta nxitur PES-in të minimizojë koston neto të debalancit. Mekanizmat e tillë do të hyjnë në fuqi atëherë kur rregullatori konsideron se FPEE-ja në masë të konsiderueshme mund t'i kontrollojë këto kosto.
- 8 Të Hyrat e Lejuara që kanë të bëjnë me humbjet e energjisë në transmision apo në shpërndarje përbëhen nga vlera reale e faturës që lëshohet nga FPEE-ja për OSSHnë dhe OST-në (siç përcaktohet në Rregullat e Tregut) për të kompensuar për ndryshimin në mes të energjisë së matur të dërguar nga gjeneratorët apo të importuar, dhe energjisë së shpërndarë deri te Konsumatorët e Rregulluar.

- 9 Parashikimi i kostos së lejuar të blerjes së energjisë me shumicë gjatë Shqyrtimeve Periodike do të marrë parasysh:
- 9.1 Ndryshimet e reja dhe ato historike të çmimit të importit, koston së gjenerimit vendor si dh të hyrat që kanë të bëjnë me humbjet në transmision dhe në shpërndarje;
 - 9.2 Ndryshimet sezonale në çmimet e eksportit dhe të importit;
 - 9.3 Çmimet e kontratave relevante për shkëmbim të energjisë; dhe
 - 9.4 Faktorët e tjerë që ofrojnë mekanizma të besueshëm për parashikimin e koston së energjisë me shumicë.
- 10 Marzha e Energjisë me Shumicë do të jetë një përqindje e caktuar që do t'i aplikohet ndryshimit në mes të koston së aktuale të lejuar të blerjes së energjisë me shumicë në këtë Vit Relevant dhe koston së njëjtë të Vitit Relevant ekuivalent paraprak. Marzha e Energjisë me Shumicë do të jetë e mjaftueshme që të nxisë FPEE-në për të zvogëluar koston e blerjes së energjisë me shumicë por të mos rezultojë në përfitime të tepërta për FPEE-në apo në humbje që mund të rrezikojnë pozicionin financiar afatgjatë të FPEE-së. Marzha e Energjisë me Shumicë do të përcaktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike.
- 11 Nxitja për eksport do të jetë një përqindje fikse që i aplikohet të hyrave të realizuara nga eksporti në Vitin e tanishëm Relevant që kanë të bëjnë me ofrimin Shërbimeve Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar dhe do të vendosë ndarjen e këtyre të hyrave në mes të FPEE-së dhe konsumatorëve. Nxitja për eksport duhet të jetë e mjaftueshme që të nxisë FPEE-në të maksimizojë të Hyrat nga Eksporti por të mos rezultojë në ofrojë përfitime të tepërta për FPEE-në. Nxitja për eksport do të përcaktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike.
- 12 Nëse FPEE-ja eksporton energji elektrike kur në vend ka shkyçje të energjisë për shkak të mungesës së kapaciteteve gjeneruese apo importit, siç mund të vërtetohet nga të dhënat e ofruara nga OST-ja, të Hyrat e Lejuara Maksimale të FPEE-së do të reduktohen për Ndëshkimin e Eksportit gjatë Përshtatjes së ardhshme të Rregullt. Ndëshkimi për Eksport do të shprehet si ndëshkim për çdo njësi të energjisë që nuk është shërbyer, siç përcaktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike, dhe do të shumëzohet me sasinë e energjisë që nuk është shërbyer. Ndëshkimi për çdo njësi do të jetë i mjaftueshëm për të nxitur FPEE-në që të shërbejë kërkesën vendore para se të eksportojë, duke caktuar ndëshkimin mbi koston e pritur të importit, por nuk duhet të rrezikojë gjendjen financiare të FPEE-së.
- 13 Për të llogaritur koston e blerjes së energjisë me shumicë, një pjesë e koston së gjithmbarshme të energjisë me shumicë të FPEE-së do t'u alokohet Konsumatorëve të Rregulluar në mënyrë që nuk e çrregullon konkurrencën për Konsumatorët e Parregulluar. Siç është sqaruar në Shtojcën 8, gjatë Periudhës Tranzitore do të aplikohen provizione të veçanta.

Neni 11 Kostoja me shumicë për Kapacitet

[Do të plotësohet me rastin e finalizimit të dizajnit të tregut]

Neni 12 Bartja e Ngarkesave të OT-së

- 1 FPEE-ja do të bartë Ngarkesat e OT-së që i faurohen nga OT-ja dhe që kanë të bëjnë me Konsumatorët e Rregulluar. Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përshtaten për të reflektuar ndryshimet në Ngarkesat e OT-së gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.

- 2 Për të llogaritur Ngarkesat e OT-së që kanë të bëjnë me Konsumatorët e Rregulluar, shuma totale e ngarkesave të OT-së do të alokohet në mënyrë që i prezervon sinjalet e çmimeve në këto ngarkesa.

Neni 13 Bartja e Ngarkesave të OS-së

- 1 FPPEE-ja do të bartë Ngarkesat e OS-së që i faurohen nga OS-ja dhe që kanë të bëjnë me Konsumatorët e Rregulluar. Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përshtaten për të reflektuar ndryshimet në Ngarkesat e OS-së gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.
- 2 Për të llogaritur Ngarkesat e OS-së që kanë të bëjnë me Konsumatorët e Rregulluar, shuma totale e ngarkesave të OS-së do të alokohet në mënyrë që i prezervon sinjalet e çmimeve në këto ngarkesa.

Neni 14 Bartja e Ngarkesave TUOS

- 1 FPPEE-ja do të bartë Ngarkesat TUOS që i faurohen nga OST-ja dhe që kanë të bëjnë me Konsumatorët e Rregulluar. Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përshtaten për të reflektuar ndryshimet në Ngarkesat TUOS gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.
- 2 Për të llogaritur Ngarkesat TUOS që kanë të bëjnë me Konsumatorët e Rregulluar, shuma totale e Ngarkesave TUOS do të alokohet në mënyrë që i prezervon sinjalet e çmimeve në këto ngarkesa.

Neni 15 Bartja e Ngarkesave DUOS

- 1 FPPEE-ja do të bartë Ngarkesat DUOS që i faurohen nga OSSH-ja dhe që kanë të bëjnë me Konsumatorët e Rregulluar. Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përshtaten për të reflektuar ndryshimet në Ngarkesat DUOS gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.
- 2 Për të llogaritur Ngarkesat DUOS që kanë të bëjnë me Konsumatorët e Rregulluar, shuma totale e Ngarkesave DUOS do të alokohet në mënyrë që i prezervon sinjalet e çmimeve në këto ngarkesa.

Neni 16 Bartja e Taksave të Licencës

- 3 FPPEE-ja do të bartë pjesën e Taksës së Licencës që ka të bëjë me Konsumatorët e Rregulluar. Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përshtaten për ndryshimet në Taksën e Licencave gjatë Përshtatjeve të Rregullta, sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.

Neni 17 Metodologjia për Strukturimin e Tarifës së Rregulluar me Pakicë

- 1 Struktura e Tarifës së Rregulluar me Pakicë do të jetë në përputhje me metodologjinë e caktuar në këtë Nen dhe në udhëzimet e tjera që mund të lëshohen nga Rregullatori.
- 2 Një bashkësi e vetme e çmimeve do të aplikohet ndaj një Grupi të caktuar të Konsumatorëve.
- 3 Tarifa e Rregulluar me Pakicë nuk do të ketë ndër-subvencionim në mes të Grupeve të Konsumatorëve, përveç gjatë Periudhës Tranzitore të dhënë në Shtojcën 8.
- 4 Tarifa e Rregulluar me Pakicë do të marrë paraysh çështjet ambientale.
- 5 Bllok tarifat mund të përdoren për të nxitur konsumin efikas të energjisë elektrike. Njëkohësisht, këto tarifa mund të përdoren për raste sociale kur Rregullatori nuk është i kënaqur me nivelin e mbulueshmërisë së konsumatorëve në nevojë nga mekanizmat e tjerë subvencionues.
- 6 Tarifa e Rregulluar me Pakicë do të përfshijë tarifat ditë-natë për të nxitur konsumin efikas të energjisë elektrike në rastet kur ka matës adekuat dhe në rastet kur profili i ngarkesës është i përshtatshëm.
- 7 Tarifa e Rregulluar me Pakicë do të variojë për të reflektuar koston sezonale të ofrimit të shërbimit, për të nxitur konsumin efikas të energjisë elektrike.
- 8 Tarifa e Rregulluar me Pakicë do të reflektojë koston e furnizimit të Kategorive të ndryshme të Konsumatorëve për të ndihmuar në menaxhimin afatgjatë të kërkesës së pikut dhe për të nxitur konsumatorët të konsumojnë energjinë në mënyrë efikase. Në këtë drejtim, Tarifa e Rregulluar me Pakicë do të:
 - 8.1 Mbulojë koston e lejuar mesatare me pakicë për furnizim të kategorive të ndryshme të konsumatorëve;
 - 8.2 Reflektojë koston marginale për energji dhe kapacitet të furnizimit të Kategorive të ndryshme të Konsumatorëve në kohë të ndryshme brenda ditës dhe brenda sezonës.
 - 8.3 Prezervojë në mënyrë të saktë sinjalet e çmimeve për Ngarkesat e OT-së, Ngarkesat e OS-së, Ngarkesat TUOS, Ngarkesat DUOS dhe Taksat për Licenca.

SHTOJCA 1**LLOGARITJA E TË HYRAVE MAKSIMALE TË LEJUARA**

1 Kjo shtojcë paraqet formulat për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara për FPEE-në. Kjo shtojcë komplementon parimet e dhëna në pjesën e parë të Rregullës.

2 Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR_t) do të llogariten sipas formulës:

$$MAR_t = (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t + NTFR_t + KREV_t) / (1 - BDTA_t)$$

Ku

MAR_t paraqet Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin Relevant t

$RETR_t$ paraqet të Hyrat e Lejuara me pakicë në Vitin Relevant t , të cilat caktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike ashtu që Vlera Neto e Tanishme (gjatë Periudhës Rregullative kur merr parasysh X-faktorin) të jetë e barabartë me Vlerën Neto të Tanishme të kostove të lejuara me pakicë, duke mos përfshirë koston e Borxhit të Keq

$WHPC_t$ paraqet koston e lejuar të blerjes së energjisë me shumicë gjatë Vitit Relevant t , duke përfshirë koston e lejuar të blerjes së energjisë dhe koston e kapacitetit

$PSTC_t$ paraqet koston që bartet gjatë Vitit Relevant t , duke përfshirë këtu Ngarkesat OT, Ngarkesat OS, Ngarkesat TUOS, Ngarkesat DUOS dhe Taksat për Licenca

$NTFR_t$ janë të hyrat jo-tarifore që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar në Vitin Relevant t , duke përfshirë këtu ndryshimin në mes të vlerës së shitjes së asetit dhe vlerës rregullative të tyre

$KREV_t$ është faktori korrektues i të Ardhurave gjatë Vitit Relevant t që parashihen të jenë zero gjatë Shqyrtimeve Periodike

$BDTA_t$ është Lejesa për Borxhin e Keq gjatë Vitit Relevant që caktohet në Shqyrtimin Periodik dhe mund të jetë vlerë konstante apo vlerë që zvogëlohet Periudhës Rregullative

2.1 Të Hyrat e lejuara me pakicë ($RETR_t$) do të llogariten gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulës në vijim:

$$RETR_t = RETR_{t-1} * (1 + CPI_{t-1} - X_t)$$

Ku

$RETR_t$ paraqet të Hyrat e lejuara me pakicë në Vitin Relevant t

$RETR_{t-1}$ paraqet të Hyrat e lejuara me pakicë në Vitin Relevant $t-1$ përveq gjatë Vitit Relevant 1 kur do të përdoret një vlerë e caktuar nga ZRRE-ja gjatë Shqyrtimit të mëvonshëm Periodik

CPI_{t-1} është vlera e realizuar e inflacionit në Vitin Relevant $t-1$, matur duke përdorur Indeksin e Harmonizuar të çmimeve të Konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i

X_t është X-faktori në Vitin Relevant t , që caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike

2.2 Kostoja e lejuar e blerjes së energjisë me shumicë ($WHPC_t$) do të llogaritet gjatë Përshtatjeve të Rregullta duke përdorur formulën:

$$WHPC_t = WHPCf_t + (WHPCa_{t-1} - WHPCf_{t-1}) * (1 + I_t) - (WHECa_{t-1} - WHECa_{t-2}) * WHEM_t + EXPR_{t-1} * EXPF_t - EXPP_t$$

ku

$WHPC_t$ është kostoja e lejuar e blerjes së energjisë me shumicë në Vitin Relevant t

$WHPCf_t$ Është vlerë e përcaktuar nga ZRRE-ja për Vitin e parë Relevant të çdo periudhe Rregullative. Për Vitin e dytë Relevant, dhe Vitet Relevante Pasuese, kjo vlerë do të azhurnohet duke përdorur ndryshimet në çmimet e blerjes së energjisë dhe vëllimit të blerjes së energjisë për gjeneratorët e rregulluar në Kosovë dhe vëllimin e neto importit dhe çmimin e importit për vitin e ardhshëm të kontratave për ngarkesë bazë të dhëna në European Energy Exchange, apo duke përdorur mënyrë alternative të parashikimit kur Rregullatori konsideron se çmimet e indeksuara nuk reflektojnë pritje të arsyeshme të çmimeve me shumicë

$WHPCa_{t-1}$ paraqet koston e realizuar të blerjes së energjisë me shumicë në Vitin Relevant $t-1$

$WHPCf_{t-1}$ paraqet kostone parashikuar të blerjes së energjisë me shumicë në Vitin Relevant $t-1$

I_t është norma e interesit për Vitin Relevant t që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 1% (e përshtatur për të reflektuar kohëzgjatjen e Vitit Relevant)

$WHECa_{t-1}$ është kostoja e realizuar e blerjes së energjisë me shumicë në Vitin Relevant $t-1$

$WHECa_{t-2}$ është kostoja aktuale e lejuar për blerjen e energjisë në Vitin Relevant $t-2$ ose, nëse Viti Relevant është më pak se 1 vit, duhet të merret parasysh Viti Relevant një vit para Vitit Relevant $t-1$

$WHEM_t$ paraqet Marzhën e Energjisë me Shumicë në Vitin Relevant t

$EXPRa_{t-1}$ paraqet të hyrat e realizuara të eksportit që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar në Vitin Relevant $t-1$

$EXPF_t$ paraqet nxitjen e eksportit, të aplikueshme në Vitin Relevant t , që është një përqindje fikse, e caktuar në Shqyrtimin Periodik

$EXPP_t$ është Ndëshkimi për Eksport që i aplikohet Vitit Relevant t e që llogaritet si më poshtë:

$$EXPP_t = EXPR_t * USEG_{t-1}$$

ku

$EXPR_t$ është Norma e Ndëshkimit për Eksport (shprehur në €/MWh), që caktohet në Shqyrtimin Periodik dhe indeksohet për të marrë parasysh ndryshimet e çmimeve për vitin vijues të kontratave për kërkesë bazë në European Energy Exchange

$USEG_{t-1}$ është sasia (në MWh) e kërkesës vendore që në mënyrë të padashur nuk është shërbyer gjatë Vitit Relevant t-1 si rezultat i mungesës së mjaftueshme të gjenerimit dhe importit

2.3 Kostot që barten ($PSTC_t$) do të llogariten gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulës:

$$PSTC_t = PSTCf_t + (PSTCa_{t-1} - PSTCf_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku

$PSTC_t$ paraqet kostot që barten gjatë Vitit Relevant t

$PSTCf_t$ paraqet kostot që ishin parashikuar të barten gjatë Vitit Relevant t, të azhurnuara për të reflektuar ndryshimet në Ngarkesat e OT-së, Ngarkesat e OS-së, Ngarkesat TUOS, Ngarkesat DUOS dhe Taksat për Licenca

$PSTCa_{t-1}$ është vlera e realizuar e kostove që barten në Vitin Relevant t-1

$PSTCf_{t-1}$ është vlera e parashikuar e kostove që barten në Vitin Relevant t-1

I_t është norma e interesit për Vitin Relevant t që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 1% (e përshtatur për të reflektuar kohëzgjatjen e Vitit Relevant)

2.4 Faktori i përshtatjes së të Hyrave ($KREV_t$) do të llogaritet gjatë Përshtatjeve të Rregullta duke përdorur formulën në vijim:

$$KREV_t = (MAR_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

ku

ARR_{t-1} paraqet Të Hyrat aktuale të Rregulluara gjatë Vitit Relevant t-1

MAR_{t-1} paraqet Të Hyrat Maksimale të Lejuara gjatë Vitit Relevant t-1

I_t është norma e interesit për Vitin Relevant t që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 1% (e përshtatur për të reflektuar kohëzgjatjen e Vitit Relevant)

SHTOJCA 2

BAZA E ASETEVE TË RREGULLUARA

- 1 Kjo Shtojcë përshkruan vlerësimin e Bazës së Aseteve të Rregulluara për qëllime të llogaritjes së Zhvlerësimit të lejuar (Neni 9).
- 2 Baza e Aseteve të Rregulluara do të jetë vlerë rregullative e shumës së asetëve të përdorura dhe të përdorshme të FPPE-së që janë të nevojshme për kryerjen e shërbimit ndaj Konsumatorëve të Rregulluar. Baza e Aseteve të Rregulluara do të ndahet kategoritë e ndryshme të asetëve.
- 3 Baza e Aseteve të Rregulluara do të azhurnohet në çdo Shqyrtim Periodik si më poshtë:
 - 3.1 Kostoja e lejuar e zhvlerësimit gjatë Periudhës Rregullative të tanishme do të zbritet nga Baza e Aseteve të Rregulluara dhe do të llogaritet në mënyrë linear duke përdorur Jetëgjatësinë Ekonomike;
 - 3.2 Shitja e Aseteve gjatë Periudhës së tanishme Rregullative do të zbritet nga Baza e Aseteve të Rregulluara bazuar në vlerën rregullative. Ndryshimi në mes të vlerës së shitur dhe vlerës rregullative do të zbritet nga të Hyrat Maksimale të Lejuara për Periudhën e ardhshme Rregullative;
 - 3.3 Shpenzimet e aprovuara kapitale gjatë Periudhës së tanishme Rregullative do t'i shtohen Bazës së Aseteve të Rregulluara nga data kur aset i vihet në shërbim dhe në koston e aprovuar në Planin e Aprovuar të Investimeve. Interesi gjatë ndërtimit do të kapitalizohet. Për shmangje të dyshimit, Rregullatori nuk do të bëjë reduktime retroaktive të të Hyrave në të ardhmen për të marrë parasysh ndryshimin në mes të kostos aktuale dhe kostos së aprovuar të investimit. Megjithatë, Rregullatori do të marrë parasysh koston aktuale për Shqyrtimet e më vonshme Periodike si masë për parashikimin e investimeve në të ardhmen;
 - 3.4 Nëse një projekt kapital i aprovuar në Planin e Aprovuar Investiv nuk sillet në shërbim gjatë Periudhës Rregullative në fjalë, kostoja e tij nuk i shtohet Bazës së Aseteve të Rregulluara në Shqyrtimin vijues Periodik dhe të gjitha të Hyrat e përfituara nga aset i do të zbriten në Shqyrtimin e ardhshëm Periodik;
 - 3.5 Kurdo që kostoja e mirëmbajtjes është apo ka qenë më herët e përfshirë në shpenzimet e lejuara operative, nuk do të lejohet të kapitalizohet apo të përfshihet në Bazën e Aseteve të Rregulluara; dhe
 - 3.6 Baza e Aseteve të Rregulluara do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin përgjatë Periudhës së kaluar Rregullative, duke përdorur Indekset e Harmonizuara të çmimeve të konsumit për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat.
- 4 Jetëgjatësia Ekonomike e asetëve për kategori të ndryshme të asetëve do të përdoret për të llogaritur zhvlerësimin në Bazën e Aseteve të Rregulluara. Jetëgjatësia ekonomike do të vlerësohet gjatë Shqyrtimeve Periodike për të reflektuar jetëgjatësinë teknike të asetëve, përveç në rastet ku mund të dëshmohet se jetëgjatësia teknike ndryshon nga jetëgjatësia ekonomike e asetit.
- 5 Investimet kapitale të aprovuara do të vlerësohen gjatë Shqyrtimeve Periodike bazuar në Planin e Aprovuar Investiv për Shqyrtimin Periodik vijues. Plani i Aprovuar Investiv do të:

- 5.1 Përfshijë projektet kapitale të cilat janë të nevojshme për të ofruar Shërbimet Standarde;
 - 5.2 Identifikojë çdo projekt kapital të renditur sipas prioritetit;
 - 5.3 Tregojë përfitimin e Konsumatorëve të Rregulluar nga çdo projekt kapital, duke iu referuar, kudo që është e nevojshme, përmbushjen e ndonjë standardi të caktuar për Furnizim Standard, siç kërkohet nga Licenca e FPEE; dhe
 - 5.4 Zhvillohet duke përdorur teknika të diskontimit të rrjedhës së parasë.
- 6 Plani i Aprovuar Investiv do të implementohet si më poshtë:
- 6.1 FPEE do të përdorë të gjitha metodat e arsyeshme për të siguruar implementimin e Planit të Aprovuar Investiv në kohën dhe sipas orarit të aprovuar;
 - 6.2 Nëse FPEE, për arsye jashtë kontrollit të tyre, dështon në implementimit të investimeve kapitale në pajtim me orarin e dhënë në Planin e Aprovuar Investiv, atëherë FPEE duhet ta njoftojë Rregullatorin. FPEE duhet të japë arsye të detajuara për vonesën së bashku me orarin e ri;
 - 6.3 FPEE mund të aplikojë në çdo kohë te Rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital në Planin e Aprovuar Investiv me ndonjë projekt tjetër kapital në rastet kur mund të dëshmohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot). Nëse Rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet Bazës së Aseteve të Rregulluara në Shqyrtimin Periodik të ardhshëm. Për shmangje të dyshimit, të Hyrat Maksimale të Lejuara për periudhën e tanishme nuk do të përshtaten; dhe
 - 6.4 Nëse FPEE e zëvendëson një projekt kapital në Planin e Aprovuar Investiv me një projekt alternativ para se të marrë Arovimin e Rregullatorit, Rregullatori do të konsiderojë aprovimin e zëvendësimit në Shqyrtimin Periodik vijues por kjo nuk është obligative për Rregullatorin.

- 1 Me qëllim të ngritjes së transparencës, Rregullatori do të publikojë në ueb-faqen zyrtare të gjitha dokumentet e dorëzuara, komentet dhe dokumentet tjera relevante të pranuar nga OSSH apo palët e tjera të interesit që kanë të bëjnë me Shqyrtimin Periodik brenda [5 ditëve të punës] pas pranimit të informatave të dorëzuara nga FPEE, duke mos përfshirë këtu informatat që Rregullatori i konsideron komercialisht konfidenciale.
- 2 Rregullatori do të iniciojë Shqyrtimin Periodik jo më vonë se [gjashtë muaj] para fillimit të Periudhës së ardhshme Rregullative. Një orar tjetër do të vlejë gjatë Periudhës Tranzitore të dhënë në Shtojcën 8.
- 3 Rregullatori do të iniciojë Shqyrtimin Periodik duke njoftuar FPEE-në lidhur me:
 - 3.1 Vitet për të cilat kërkohen të dhënat për vitin aktual dhe parashikimet për të ardhmen;
 - 3.2 Formatin me anë të të cilit këto të dhëna do të dorëzohen;
 - 3.3 Orarin për dorëzimin e propozimit të FPEE-së për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Shqyrtimin e ardhshëm Periodik; dhe
 - 3.4 Orarin për procesin e përgjithshëm të shqyrtimit.
- 4 Propozimi i FPEE-së do të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe do të adresojë çështjet në vijim (pa kufizim):
 - 4.1 Të Hyrat Aktuale të Rregulluara të mbledhura nga Tarifa e Rregulluar me Pakicë gjatë Periudhës së tanishme Rregullative (duke përdorur një vlerësim të arsyeshëm për muajt e mbetur kur është e nevojshme);
 - 4.2 Koston e realizuar për ofrimin e Shërbimeve Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar gjatë Periudhës së tanishme Rregullative, në linjë me definicionet e kostos që janë përdorur për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara;
 - 4.3 Raportin vjetor dhe pasqyrat financiare të audituara për çdo vit fiskal që ka përfunduar në Periudhën e tanishme Rregullative;
 - 4.4 Nivelin e realizuar të konsumit të energjisë elektrike gjatë Periudhës së tanishme Rregullative;
 - 4.5 Parashikimin për konsumin e energjisë elektrike në Periudhën e ardhshme Rregullative;
 - 4.6 Numrin e realizuar të Konsumatorëve të Rregulluar dhe të Konsumatorëve të Parregulluar për Periudhën e tanishme Rregullative;
 - 4.7 Numrin e parashikuar të Konsumatorëve të Rregulluar dhe të Konsumatorëve të Parregulluar për Periudhën e tanishme Rregullative;
 - 4.8 Të Hyrat Maksimale të parashikuara, duke raportuar këtu ndaras për secilën prej komponentëve të kostos së lejuar, për Periudhën e ardhshme Rregullative;
 - 4.9 Propozimin për Tarifën e Rregulluar me Pakicë për Periudhën e ardhshme Rregullative; dhe

- 4.10 Çdo material tjetër shtesë që Rregullatori konsideron që duhet të përfshihet në Propozimin e FPEE-së, përderisa Rregullatori e ka njoftuar FPEE-në paraprakisht dhe me kohë të mjaftueshme për afatin e dorëzimit të propozimit të OSSH-së
- 5 Gjatë përgatitjes së Propozimit të saj, FPEE do të aplikojë plotësisht Metodologjinë e zbatuar në këtë Rregull. FPEE do të deklarojë të gjitha vendet ku nuk është aplikuar kjo Metodologji, arsyet për mos-aplikimin e metodologjisë, arsyet që përkrahin qasjen alternative dhe vlerësimin e ndikimit të përdorimit të qasjes alternative.
- 6 Pas marrjes së Propozimit të FPEE-së, Rregullatori do të vlerësojë saktësinë, relevancën dhe arsyeshmërinë e saj duke aplikuar metodologjinë e kësaj Rregulle, duke përfshirë këtu vlerësimin nëse apo jo:
- 6.1 Propozimi për Të Hyrat Maksimale të Lejuara reflekton koston e arsyeshme të ofrimit të Shërbimeve Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar;
- 6.2 Propozimi për Tarifën e Rregulluar me Pakicë rezulton në realizimin e Të Hyrave të Rregulluara që janë të barabarta me Të Hyrat Maksimale të Lejuara; dhe
- 6.3 Propozimi për Tarifën e Rregulluar me Pakicë është në përputhje me Metodologjinë për Strukturën Tarifore;
- 7 Rregullatori do të përgatisë një Vendim të Përkohshëm jo më vonë se [50 ditë pune] para fillimit të Periudhës së ardhshme Rregullative, pas konsultimit me FPEE-në. Propozimi i Përkohshëm do të paraqesë propozimet e Rregullatorit për Të Hyrat Maksimale të Lejuara që do të mbulohen nga FPEE gjatë Periudhës Rregullative si dhe justifikimin për këtë propozim. Rregullatori mund të amandamentojë, ndryshojë apo fshijë cilëndo pjesë të Propozimit të FPEE-së sipas vlerësimit të tij në rastet kur Rregullatori ofron justifikim për këto amandamente, zhvendosje apo fshirje.
- 8 Në të njëjtën kohë, pas marrjes së Vendimit të Përkohshëm, Rregullatori do të fillojë procesin e konsultimit publik mbi Vendimin Fillestar në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 9 Pas përfundimit të konsultimit publik dhe jo më vonë se [20 Ditë Pune] para fillimit të Periudhës së Ardhshme Rregullative, Rregullatori duhet të marrë Vendimin Final për të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe për Tarifën e Rregulluar me Pakicë për Periudhën e ardhshme Rregullative. Vendimi i Rregullatorit do të jetë në pajtueshmëri me këtë Rregull. Orar alternativ do të aplikohet gjatë Periudhës Tranzitore të dhënë në Shtojcën 8.
- 10 Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Tarifat e Rregulluara me Pakicë të dhëna në Vendimin Final të Rregullatorit do të aplikohen nga data e fillimit të Periudhës së ardhshme Rregullative. FPEE-ja do t'i faturojë konsumatorët në përputhje me këtë vendim.
- 11 FPEE mund të apelojë vendimin e Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

SHTOJCA 4

PROCESI I PËRSHTATJEVE TË RREGULLTA

- 1 FPEE do të dorëzojë te Rregullatori propozimin për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe përshtatjen e nevojshme për Tarifën e Rregulluar me Pakicë për Vitin e ardhshëm Relevant së paku [20 Ditë Pune] para fillimit të Vitit të ardhshëm Relevant. FPEE po ashtu do të përfshijë në këtë dorëzim edhe dokumentet relevante dhe evidencën përfshirë vlerat që kanë të bëjnë me komponentët e formulave të Përshtatjeve të Rregullta të dhëna në Shtojcën 1 si dhe çdo informatë tjetër të kërkuar nga Rregullatori.
- 2 Rregullatori mund të kërkojë nga FPEE që të japë sqarime shtesë për metodën e llogaritjes së propozimit për Të Hyrat Maksimale të Lejuara apo të Tarifës së Rregulluar me Pakicë dhe, në këto raste, OSSH do të ofrojë, brenda një periudhe të shpejtë kohore, të gjitha informatat e kërkuara nga Rregullatori.
- 3 Rregullatori do ta informojë FPEE-në së paku [5 Ditë Pune] para fillimit të Vitit të Ardhshëm Relevant nëse e aprovon llogaritjen e FPEE-së për të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe për Tarifën e Rregulluar me Pakicë.
- 4 Nëse Rregullatori e aprovon propozimin për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Tarifën e Rregulluar me Pakicë, atëherë këto do të jenë Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Tarifë e Rregulluar me Pakicë për Vitin e ardhshëm Relevant.
- 5 Nëse Rregullatori nuk e aprovon propozimin për të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Tarifën e Rregulluar me Pakicë, Rregullatori do të japë arsyetim dhe evidencë për këtë, në pajtim me këtë Rregull. Tarifa e Rregulluar me Pakicë nuk do të ndryshojnë deri sa Rregullatori të aprovojë një propozim alternativ ose të ofrojë llogaritjen për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Tarifën e Rregulluar me Pakicë.
- 6 Çdo ndryshim në të Hyra që mund të rezultojë nga llogaritja e gabuar e Të Hyrave të Lejuara raportimi i gabuar i Të Hyrave Rregullative të realizuara apo apelimet lidhur me Përshtatjen e Rregullt do të mbulohen në Vitet Relevante vijuese.
- 7 Nëse Rregullatori nuk reagon ndaj FPEE-së brenda kohës së kërkuar atëherë supozohet automatikisht se propozimi për të Hyrat Maksimale të Lejuara aprovohet dhe propozimi për Tarifat e Rregulluara me Pakicë bëhet efektiv nga dita e parë e Vitit Relevant vijues.
- 8 FPEE-ja mund të apelojë çdo vendim të Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

SHTOJCA 4

PROCESI I SHQYRTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM

- 1 Nëse ka ndodhur një Ngjarje e Jashtëzakonshme, FPEE-ja mund të kërkojë Shqyrtim të Jashtëzakonshëm.
- 2 Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm nuk mund të fillojë brenda [gjashtë muajsh] të Shqyrtimit Periodik apo para kompletimit të një Shqyrtimi të Jashtëzakonshëm të kaluar.
- 3 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm mund të ketë lidhje me më shumë se një Ngjarje të Jashtëzakonshme. Në këto raste kjo Shtojcë adreson ndikimin e përbashkët financiar të këtyre Ngjarjeve.
- 4 Brenda [20 Ditëve të Punës] pas kërkesës së FPEE-së për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm, FPEE duhet të dorëzojë Deklaratën për Ndikimin Financiar që do të përfshijë çështjet në vijim:
 - 4.1 Përshkrimin e Ngjarjes së Jashtëzakonshme që ka qenë shkak i kërkesës për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm;
 - 4.2 Përshkrimin e ndikimit të Ngjarjes së Jashtëzakonshme në biznesin e FPEE-së;
 - 4.3 Vlerësimin e ndryshimit të kostove të FPEE-së për ofrimin e Shërbimeve Standarde ndaj Konsumatorëve të Rregulluar në çdo vit nga data e Ngjarjes së Jashtëzakonshme deri në fundin e Periudhës së tanishme Rregullative
 - 4.4 Vlerësimin për ndryshimin në të hyrat e parashikuara nga Tarifa e Rregulluar me Pakicë që rezultojnë nga Ngjarja e Jashtëzakonshme në çdo vit nga data e Ngjarjes së Jashtëzakonshme deri në përfundim të Periudhës së tanishme Rregullative;
 - 4.5 Llogaritjen për ndikimin financiar të Ngjarjes së Jashtëzakonshme në çdo vit, duke llogaritur si shuma e ndryshimeve në koston dhe të Hyrat e FPEE-së. Të Hyrat do të trajtohen si numër pozitiv dhe koston do të trajtohen si numra negativ; dhe
 - 4.6 Llogaritjen nëse apo jo ndikimi financiar pritet të jetë më i lartë se Pragu i Materialitetit, shumëzuar me të Hyrat e FPEE-së (në vitin para Ngjarjes së Jashtëzakonshme), shumëzuar me numrin e viteve në mes të datës së Ngjarjes së Jashtëzakonshme dhe fundit të Periudhës Rregullative. Pragu i Materialitetit duhet të jetë një përqindje fikse që caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike;
- 5 Nëse FPEE vlerëson se ndikimi financiar është më i lartë se Pragu i Materialitetit, OSSH duhet të përfshijë në Deklaratën e Ndikimit Financiar propozimin për Përshtatjen e Jashtëzakonshme në Të Hyrat Maksimale të lejuara dhe të Tarifës së Rregulluar me Pakicë. Propozimi për Përshtatjen e Jashtëzakonshme duhet t'u përmbahet kushteve në vijim:
 - 5.1 Përshtatja e jashtëzakonshme duhet të ndryshojë Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Tarifën e Rregulluar me Pakicë në atë mënyrë që Vlera Neto e Tanishme e ndryshimeve të parashikuara është e barabartë (por jo me shenjë të kundërt) me Vlerën Neto të Tanishme të ndikimit financiar të Ngjarjes së Jashtëzakonshme;
 - 5.2 Tarifa e Re e Rregulluar me Pakicë duhet të jetë në përputhje me Metodologjinë për Strukturën Tarifore dhe, kurdo që është e mundur, të jetë në përputhje me Strukturën Tarifore që ka ekzistuar para ndodhjes së Ngjarjes së Jashtëzakonshme; dhe

- 5.3 Kohëzgjata dhe struktura e Përshtatjes së Jashtëzakonshme, ku është e mundur, duhet të reduktojnë rritjet e menjëhershme të tarifave ndaj çfarëdo Grupi Konsumatorësh (për shembull duke zbutur ndikimin e Përshtatjes së Jashtëzakonshme brenda disa viteve).
- 6 Rregullatori mund të fillojë Shqyrtim të Jashtëzakonshëm pa kërkesën e FPEE-së. Në këto raste, Rregullatori do ta njoftojë FPEE-në dhe do të përfshijë një përshkrim të Ngjarjes së Jashtëzakonshme si dhe një përshkrim të ndikimit të parashikuar. Pastaj, FPEE do të përgatisë Deklaratën për Ndikimin financiar sipas procesit të përshkruar më lartë.
- 7 Rregullatori mund të kërkojë sqarime shtesë për mënyrën e llogaritjes së Deklaratës për Ndikimin Financiar si dhe për Përshtatjen e Jashtëzakonshme dhe, në bazë të kësaj kërkesë, FPEE do t'i dërgojë Rregullatorit, brenda një afati sa më të shkurtër kohor, informatat e kërkuara.
- 8 Brenda [20 ditëve] pas marrjes së Deklaratës për Ndikimin Financiar, Rregullatori do të njoftojë FPEE-në nëse Rregullatori e pranon apo jo propozimin e FPEE-së për Përshtatjen e Jashtëzakonshme. Rregullatori do ta aprovojë propozimin nëse propozimi:
- 8.1 I plotëson kushtet e përshkuara më lartë;
- 8.2 Është llogaritur në mënyrë të saktë; dhe
- 8.3 Merr parasysh të gjitha informatat e nevojshme dhe të mundshme gjatë asaj kohe.
- 9 Nëse Rregullatori e aprovon propozimin për Përshtatjen e Jashtëzakonshme, propozimi për të Tarifën e Rregulluar me Pakicë do të jetë efektiv menjëherë.
- 10 Nëse Rregullatori nuk e aprovon propozimin për Përshtatjen e Jashtëzakonshme, Rregullatori duhet të ofrojë arsyetimin dhe evidencën për këtë, në pajtim me këtë Rregull. Tarifa e Rregulluar me Pakicë nuk do të përshtatet deri sa Rregullatori të aprovojë një propozim.
- 11 Nëse Rregullatori nuk e këshillon FPEE-në brenda afatit të kërkuar (lart), supozohet automatikisht se propozimi për Përshtatjen e Jashtëzakonshme është aprovuar dhe propozimi bëhet efektiv menjëherë.
- 12 FPEE mund të apelojë çdo vendim të Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

- 1 Ngjarja e Jashtëzakonshme ndodhë në rastet e mëposhtme:
 - 1.1 Çdo ndryshim mbi 3% në taksat e aplikueshme mbi FPEE-në dhe që nuk mbulohet tërësisht në Përshtatjet e Rregullta;
 - 1.2 Çdo forcë madhore që është definuar në Shtojcën 7;
 - 1.3 Çdo ngjarje tjetër që përmbushë të gjitha kushtet në vijim:
 - (i) Nuk është paraparë në mënyrë të arsyeshme;
 - (ii) Nuk ka qenë nën kontrollin e FPEE-së;
 - (iii) FPEE nuk është i obliguar ta ndalojë atë;
 - (iv) Nuk do të mbulohet në Përshtatjet e Rregullta; dhe
 - (v) Ndryshon në masë të konsiderueshme të Hyrat dhe/ose kostot e FPEE-së për ndonjë periudhë të caktuar 12 mujore, në atë mënyrë që mund të vlerësohet që mund të tejkalohet Pragu i Materialitetit (i sqaruar në Shtojcën 5).
- 2 Ndodhja e Ngjarjes së Jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të filluar Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm por, siç është sqaruar në Shtojcën 5, Ngjarja duhet të kalojë Pragu e Materialitetit në mënyrë që të përshtaten Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Tarifa e Rregulluar me Pakicë.

SHTOJCA 6

NGJARJA E FORCËS MADHORE

- 1 Forca Madhore është ngjarje e jashtëzakonshme apo rrethanë që i përmbushë të gjitha kushtet në vijim:
 - 1.1 Është jashtë kontrollit të FPEE-së;
 - 1.2 FPEE nuk ka mundur ta parandalojë atë;
 - 1.3 FPEE nuk ka mundur ta shmangë apo ta tejkalojë; dhe
 - 1.4 Nuk i atribuohet FPEE-së.
- 2 Forca madhore mund të përfshijë, por nuk kufizohet me ngjarjet e veçanta apo rrethanat e paraqitura më poshtë atëherë kur kushtet e lartpërmendura janë përmbushur:
 - 2.1 Luftë, gjendje lufte apo veprime ushtarake (pavarësisht se a është deklaruar luftë apo jo), invazion, akt i armiqve të jashtëm;
 - 2.2 Rrebelim, terrorizëm, sabotim nga persona që nuk janë punonjës të FPEE-së, kontraktorë apo nënkontraktorë, revolucion, kryengritje, uzurpim apo luftë civile;
 - 2.3 Trazirë, rrëmuje, grevë apo lokaut nga persona që nuk janë punonjës, kontraktorë apo nën-kontraktorë të palës;
 - 2.4 Municione të luftës, materiale eksplozive, rrezatim ionizues apo kontaminim me radio-aktivitet, përveç kur këto mund t'i atribuohen përdorimit të palës; dhe
 - 2.5 Katastrofat natyrore si tërmeti, tsunami, tajfuni apo aktivitetet vullkanore.

- 1 Periudha Tranzitore do të jetë prej 1 prill 2012 deri më 31 mars 2015.
- 2 Periudha Rregullative do të jetë si vijon:
 - 2.1 Nga data 1 prill 2012, Periudha Rregullative dot jetë [1 vit]; dhe
 - 2.2 Nga data 1 prill 2013, Periudha Rregullative dot jetë [2 vite].
- 3 Rregullatori do ta definojë vlerën fillestare të Bazës së Aseteve të Rregulluara (për datën 1 prill 2012) para fillimit të Periudhës së parë Rregullative.
- 4 Kostoja e blerjes së energjisë me shumicë do të llogaritet gjatë Periudhës Tranzitore si më poshtë:
 - 4.1 Kostoja totale e blerjes së energjisë me shumicë e FPPE-së do të alokohet në mes të Konsumatorëve të Rregulluar dhe Konsumatorëve të Parregulluar në bazë të barabartë sipas konsumit, përveç kur ka obligim për një entitet të ndryshëm nga FPPE-ja të blejë energji për furnizim të Konsumatorëve të Pakualifikuar, siç kërkohet në Ligjin për Energjinë Elektrike. Në këto raste, kostoja e importit nga entiteti që e bartë këtë obligim, siç ngarkohet mbi FPPE-në, do të bartet tërësisht mbi Konsumatorët e Pakualifikuar.
- 5 Në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ndërsubvencionimet në mes të Grupeve të Konsumatorëve do të lejohen gjatë Periudhës Tranzitore si më poshtë:
 - 5.1 Kudo që historikisht ka shtrembërim të konsiderueshëm të çmimeve, Tarifa e Rregulluar me Pakicë mund të lejojë ndër-subvencionime në mes të Grupeve të Konsumatorëve;
 - 5.2 Ndër-subvencionimet do të ribalancohen gradualisht deri më 31 dhjetor 2014, prej të cilës datë nuk do të ketë ndër-subvencionime; dhe
 - 5.3 Për qëllime të rebalancimit gjatë Periudhës Tranzitore, struktura e Tarifës së Rregulluar me Pakicë mund të ndryshojë brenda Periudhës Rregullative. Ndryshimet duhen definuar nga Rregullatori gjatë Shqyrtimeve Periodike për të zbutur rebalancimin sa më shumë që është e mundur. Ndryshimet mbi strukturën duhen implementuar në të njëjtën kohë me Përshtatjet e Rregullta.
- 6 Gjatë Periudhës Tranzitore, FPPE-ja do të dorëzojë propozimin, jo më vonë se 3 muaj para përfundimit të Periudhës së Tanishme Rregullative, dhe Rregullatori do të marrë Vendimin Final jo më vonë se [10 Ditë Pune] para përfundimit të Periudhës së tanishme Rregullative.